



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:057127
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05508845

AA.nr.487/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve, L.L, E.L dhe E.L, Komuna Deçan, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Divizioni për Ndihmë Sociale të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.684/2021 të datës 29.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësve, L.L, E.L dhe E.L, Komuna Deçan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.684/2021 i datës 29.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.684/2021 të datës 29.03.2023, është refuzuar kërkesëpadia e paditësve, L.L, E.L dhe E.L, komuna e Deçanit, me të cilin kanë kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Divizioni për Ndihmë Sociale të Republikës së Kosovës në Prishtinë me nr.3956 të datës 18.01.2021, dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti njihet e drejta në ndihmën sociale sipas Masës 15 të Pakos Emergjente për muajt Prill, Maj dhe Qershor, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë paditësit, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të prishët dhe lënda të kthehet ne rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhimave Sociale, në Prishtinë, me vendimin me Nr.prot.3956 të dt. 18.01.2021, në pikën I. e ka refuzuar ankesën nr.23689 të dt.31.08.2020 te L.L e lindur me ... me nr personal... , Komuna e Deqanit. Ndersa në pikën II. e ka refuzuar kerkesen per asistenc mujore ne vlere prej 130.00 euro sipas pikes 1 te ketij vendimi eshte per muajin 04-2020. Kurse në pikën III mbetet ne fuqi aktevendimi nr 14333 i dt.20.05.2020 i Qendres per Pune Sociale QPS-Deqan.

Paditësit të pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhimave Sociale në Prishtinë, kanë ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.03.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është e pa bazuar. Me vendimin e datës 18.01.2021, i është refuzuar si e papranueshme ankesa me nr. Protokolli 3956 e dt.18.01.2021, familjes se L.L nga Deçani për asistencë mujore familjare sipas Masës nr.15 të Qeverisë së Kosovës. Në vendimin e tillë me të cilin është refuzuar ankesa, Komisioni ka dhënë arsyetimin se pas administrimit të provave të bashkangjitura nga pala, ka konstatuar se L.L nuk ka ofruar dëshmitë dhe provat e nevojshme, të cilat i kundërshtojnë raportet e verifikimit të bëra nga krahasimet me ATK/MF, ARC/MPB, APRK dhe TMF/MPMS. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur Gjykata e shkallës së parë iu referua Planit operacional për pakon

fiskale emergjente të Qeverisë, përkatësisht Masës 15. Po ashtu, në linjë me planin operacional gjykata e shkallës së parë iu referua Vendimit të Qeverisë Nr.35/2020 të datës 16.04.2020 për caktimin e kriterëve për përfituesin e Masës Emergjente Fiskale MASA nr.15 i cili vendim në pikën 2. ka përcaktuar: *Të drejtën e përfitimit në pagesë të asistencës mujore në vlerë prej Njëqind e tridhjetë (130) Euro për periudhën Prill-Qershor 2020, e kanë familjet të cilat nuk e kanë asnjë të punësuar (sektorin publik dhe privat), nuk pranojnë asnjë pagesë mujore nga Buxheti i Republikës së Kosovës (pension apo asistencë tjetër sociale), janë të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent dhe që janë banor rezident në Republikën e Kosovës. Dhe pika 3 ka përcaktuar: Për te përfituar nga Masa nr.15, parashtruesi i kërkesës është i obliguar të jetë i regjistruar i pa punë në Zyrën e Punësimit, të dorëzojë kopjen e letërnjoftimit, kopjen apo konfirmimin e llogarisë së bankës dhe plotësoj formën e aplikacionit që duhet të jetë i nënshkruar nga parashtruesi, nëpërmjet aplikimit online (opsion i rekomanduar fuqimisht) apo aplikimit në formë fizike. Nga provat e administruara të cilat gjenden në shkresa të lëndës gjykata e shkallës së parë ka gjetur se aplikantja-paditësja i ka bashkangjitur vërtetimet e papunësisë për veten dhe familjaret të lëshuar nga MPMS si në vijim: vërtetimi i papunësisë për L.L i datës 19.01.2021, vërtetimi i papunësisë për E.L, vërtetimi i papunësisë për E.L, ndërkaq, nuk ka paraqitur asnjë provë për anëtarin tjetër të familjes-bashkëshortin e saj A.L i cili ndër të tjera në formularin për parashtrimin e ankesës kundër vendimit nr.144177 te datës 27.07.2020, dhe raportit te verifikimit nr.138425 te datës 27.07.2020, deklaroi se “jam invalid i luftës me shkalle të invalidit 45% e cila ndihmë nuk më mjafton as për barna. Gjykata e shkallës së parë nga shtjellimi i të lartë cekurave ka vlerësuar se paditësja me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka përmbushur të gjitha kriteret siç është theksuar në vendimin e lartë cekur të Qeverisë dhe meqenëse nuk ka prova që dëshmojnë të kundërtën, vlerëson se, organi administrativ ka vepruar konform dispozitës se nenit 132 par.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative kur ka refuzuar ankesën e palëve paditëse dhe pretendimet e tyre në këtë çështje administrative, i gjeti të paditur për të vendosur ndryshe, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse paditësit pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me asnjë provë të vetme. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe përmbajtjen dhe formën e aktit administrative të atakuar me padi por se gjykata e shkallës së parë u lëshua në merita të shqyrtimit të kësaj çështjeje andaj paditësi nuk ka arritur të dëshmojë një gjendje faktike tjetër nga kjo e vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe kthimi I lëndës në rishqyrtim pranë organit administrativ për arsye të përmbajtjes dhe formës së aktit vetëm do të zvarriste procedurën sepse nuk janë ofruar prova për konstatimin e një gjendjeje tjetër nga kjo e konstatuar. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të paditëses dhe ka gjetur se, të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së cekur ligjore, është vërtetuar se paditësit nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.*

Nga kjo, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka

vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën për asistencë mujore të familjes L.L këtu paditëses. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësve nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditësve.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se duke u bazuar në gjendjen faktike të parashtruesve të ankesës pasi që ankuesit nuk janë në marrëdhënie pune dhe nuk kanë ekonomizim, parashtruesit e ankesës deklarojnë se na habit fakti i refuzimit të kërkesëpadisë pasi që ka pasur prova të mjaftueshme mbi gjendjen faktike të bashkangjitur padisë. Tutje, duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë i posedon të gjitha provat gjerë në marrjen e këtij aktgjykimi, kësaj ankese po ia bashkëngjisim dhe po i shtojmë edhe dëshmitë që parashtruesit e ankesës nuk kanë qenë në marrëdhënie pune nga ajo kohë që është parashtruar kërkesa për Masën 15 të Pakos Emergjente e deri në ditët e sotme pra nuk janë në marrëdhënie pune dhe i posedojnë edhe deklaratat e papunësisë nga enti i punësimit dhe nuk kanë asnjë të ardhur tjetër përveç pensionit si invalid i luftës së UÇK-së që e posedon bashkëshorti gjegjësisht babai i tyre. Bazuar në gjendjen e tyre dhe provat e bashkangjitura të njëjtëve është dashtë dhe duhet t’iu njihet e drejta e ndihmës sociale sipas Masës 15 të Pakos

Emergjente për muajit Prill , Maj dhe Qershor. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoj, për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësve, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësve janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Nga provat e administruara rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurën gjyqësore pas vlerësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës vërtetimi i papunësisë i dt.19.01.21 me nr.prot.49, vërtetimi i pa punësisë dt.19.01.21 me nr.50, për E.L, vërtetimi i papunësisë dt.19.01.21 me nr.prot.51 për E.L, formulari për shqyrtimin e ankesës dt.18.01.21 me nr.prot.3956, vendimi i dt.18.01.21. me nr.3956, kopja e letërnjoftimit për L.L dt.04.06.20, letërnjoftimi i dt.19.05.16 për E.L, deklarata e bashkësisë familjare e dt.19.01.21, kartela evidentuese e punë kërkuesit për E.L dt.20.05.16, vërtetimi i dt.23.02.21 me nr.02/21 për L.L, vërtetimi i dt.23.02.21 për E.L, vërtetimi i dt.23.02.21 për E.L, kartela evidentuese e punë kërkuesit për L.L dt.19.11.11, vendimi i dt.03.04.20, vendimi i dt.16.04.20, ankesa e dt.30.09.20, dëftesa mbi pranimin e kërkesës e dt.31.08.20 me nr.50/20, pako fiskale emergjente e masës- periudha e aplikimit dt.04.20, vendimi i dt.20.05.20, raporti i verifikimit me nr.14333 periudha 04.20, raporti i verifikimit me nr.76379 periudha 05.20, raporti i verifikimit me nr.1384/5 periudha 06.2020, me të drejtë ka konstatuar se vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, se ka mbështetje në provat e administruara, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat arsye edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditësve se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate nuk e aprovoj, pasi të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar nga organet administrative dhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë dhe se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësve.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:057127
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05508845

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.487/2023, me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit

Ramiz Kuqi